

KOSOVO



KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS
KOSOVA OLYMPIC COMMITTEE

Thirrje për brendimin e kandidatures në Lojërat Mesdhetare Prishtina 2030

Komiteti Olimpik i Kosovës, shpall konkurs publik për brendimin e identitetit të Kosovës për kandidaturen në Lojërat Mesdhetare ***Prishtina 2030***.

Aktualisht, Kosova ka statutin e shtetit kandidat për organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030.

Lojërat Mesdhetare (LM) janë ngjarje me karakter multi-sportiv të cilat zhvillohen çdo 4 vite. Në nivelin ndërkombëtar, LM klasifikohen në kategorinë e Lojërave Rajonale në të cilat marrin pjesë sportistë nga 26 shtete të tri kontinenteve që preken nga Mesdheu. Trupi udhëheqës i LM është Komitetit Ndërkombëtar për Lojërat Mesdhetare. Programi sportiv i Lojërave Mesdhetare përmbanë 23 sporte, platformë kjo e cila mundëson që në kuadër të saj të përfshihen edhe sportet ujore detare. Për sportet të cilat kërkojnë qasje në det, Kosova do të bashkëpunojë me Shqipërinë për realizimin e tyre në bregdetin shqiptar.

Mundësia për mirëpritjen e Lojërave Mesdhetare 2030 në Kosovë, shënon moment historik të zhvillimit të sportit dhe vendit. Ne jemi krenar që Kosova ka mundësinë të mirëpres organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030. Kjo do të shënonte rikthimin e këtyre lojërave madhështore në rajonin tonë pas 51 vjetëve.

Sporti dhe Lëvizja Olimpike zënë vend të veçantë në zemrën e çdo qytetari të Kosovës. Kjo si rezultat i talentit dhe sukseseve të shumta të sportistëve tanë në arenën ndërkombëtare. Përderisa e tërë bota sheh dhe dëgjon për këto rezultate, ne jemi shumë të lumtur të kemi mundësinë që këtë organizim madhështor ta sjellim afër sportistëve dhe qytetarëve të Kosovës, duke promovuar paqen, shëndetin, unitetin dhe përsosmërinë në rajonin e Mesdheut dhe më gjerë.

Koncepti i organizimit të Lojërave Mesdhetare në Kosovë, parasheh shtrirjen e organizimit në tërë territorin e Kosovës me theks të veçantë në shtatë komunat më të mëdha në vend. Përmes këtij koncepti, do të sigurojmë trashëgimi të qëndrueshme të këtij investimi, dhe njëkohësisht ndikimi do të ndjehet në çdo cep të vendit tonë.

Disa nga përfitimet që ky organizim do t'i sjellte Kosovës janë:

- Konsolidimi i imazhit shtetëror në arenën ndërkombëtare;
- Përforcim i përkatësisë dhe identitetit shtetëror;

- Infrastrukturë fizike e modernizuar;
- Ekonomi e ringjallur përmes krijimit të vendeve të reja të punës dhe zhvillimit të turizmit sportiv;
- Fuqizim i politikave sociale dhe tejkalim i sfidave të shoqërisë në përgjithësi; dhe
- Fuqizim i rezultateve sportive dhe zhvillim i qëndrueshëm i sportit në vend;

Çka përfshihet në brendim?

- Logo së bashku me udhëzuesin e përdorimit
- Adaptimi i logos në materiale promovuese (fletore, stickers, foldera, stilolapsa, tote bags, usb, mbajtëse për çelësa, gota, maica, mause pad, temporary tattoos stickers, pins).
- Brandimi i “Bidding Book” (pas hartimit të materialit përmbajtësor)

Kriteret e brendimit:

- Të jetë origjinal, unik dhe të mos jetë imitim i ndonjë logoje ekzistuese.
- Të ketë pasqyrim sportiv të veprimtarisë së Lojërave Mesdhetare;
- Të jetë kreativ, kualitativ, profesional dhe prezantues;
- Të jetë dinjitoz për identitetin e Prishtinës;
- Të jetë lehtësisht i kuptueshëm;
- Të përçojë mesazh të qartë;
- T’i rezistojë kohës dhe të jetë i lehtë për tu mbajtur në mend;
- Të jetë lehtë i përdorshëm në madhësi të ndryshme;
- Logo duhet të përmbajë edhe rrathët e Lojërave Mesdhetare (ICMG);
- Të ketë shpjegim të secilit detaj të propozuar në logo.
- Të krijohet paleta e ngjyrave kryesore dhe sekondare
- Të krijohet manuali/udhëzuesi mbi mënyrën e përdorimit të logos
- Logo të jetë e përshtatshme për vendosje në sfonde të bardha dhe të errëta, në dokumente fizike dhe në paraqitje elektronike, si: *postera fizik, broshura online dhe materiale të tjera promovuese në bazë të nevojës.*

Mënyra e aplikimit:

Të drejtë aplikimi kanë individët/artistët dhe kompanitë kreative/ të marketingut nga Kosova. Portfolio e punëve paraprake së bashku me një propozim gjeneral mbi logon duhet të dorëzohet përmes postës elektronike design@noc-kosovo.org.

Konkursi është i natyrës garuese dhe ideja më e mirë do të shpërblehet me **5000€**.

Vlerësimi i propozimeve do të bëhet nga një komision profesional i themeluar nga Komiteti Olimpik i Kosovës dhe ICMG (<https://cijm.org.gr/mediterranean-games/>)

Pas përzgjedhjes së propozimit gjeneral, njoftohet kompania apo individi i përzgjedhur dhe vazhdon faza e dytë, finalizimi i logos dhe materialeve promovuese. Të drejtat e autorit barten nga propozuesi tek Komiteti Olimpik i Kosovës.

Data e fundit për aplikim 20.05.2023

SHËNIM: Në linqet më poshtë mund të gjeni dizajnet e logove të Lojërave Mesdhetare në:
Tarragona 2018: <https://www.tarragonaturisme.cat/en/mediterranean-games-tarragona-2018>
Oran 2022: <https://www.archeryeurope.org/nees/mediterranean-games-2022-in-oran/>
Taranto 2026: <https://taranto-2026.it/en/>